





IDENTITEK

RAPORT VJETOR

JANAR – DHJETOR 2025



MISIONI YNË


IdentiTek ka si mision të ofrojë shërbime të një niveli të lartë sigurie, me integritet, të specializuar dhe në përmirësim të vazhdueshëm për prodhimin e dokumenteve biometrike në përputhje me standardet kombëtare dhe ato ndërkombëtare.

VISIONI YNË

IdentiTek ka si vizion të ndërtojë një standard dhe reputacion të padiskutueshëm për cilësi dhe profesionalizëm, duke u angazhuar në inovacionin e vazhdueshëm dhe ofrimin e zgjidhjeve të avancuara teknologjike.

VLERAT TONA

IdentiTek fokusohet në sigurinë, cilësinë, inovacionin, përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare dhe mbrojtjen e të dhënave, duke siguruar produkte të besueshme dhe të avancuara teknologjikisht.



ARRITJE 2025



PËRMIRËSIMI I KOHËS SË PRODHIMIT, SHPËRNDARJES DHE MARRJES SË SHËRBIMIT PËR PAJISJEN ME DOKUMENTE BIOMETRIKE.

(Kartë Identiteti, Pasaportë, Dokumente
Biometrike për shtetasit e huaj që jetojnë në
Shqipëri)




SHËRBIMI I KLIENTIT

Shtetasit mund të vlerësojnë shërbimin e marrë në zyrat e aplikimit.
Vlerësohen të gjitha zyrat e aplikimit me mesataren 98%.



KARTA E IDENTITETIT E SHPEJTË

U mundësohet shtetasve pajisja me kartë identiteti
brenda tre ditëve nga aplikimi.



KUPONI ELEKTRONIK KUPON

Shtetasit mund të blejnë online tarifat për kartën e
Identitetit dhe pasaportën, si brenda dhe jashtë vendit.



GJURMO DOKUMENTIN

Shtetasit mund të kontrollojnë online, në çdo moment,
ecurinë e dokumentit të tyre përmes
<https://gjurmo.identitek.al/>.



NËNSHKRIMI ELEKTRONIK

Në përfaqësitë diplomatike është përgjysmuar koha e dërgimit
të dokumenteve biometrikë, duke përmirësuar përvojën e
qytetarëve të diasporës përmes shërbimeve më të shpejta dhe
plotësisht të digjitalizuara (nga mesatarisht 13 ditë, në 3 ditë).



NDARJA E SHËRBIMEVE

Pajisja me pasaportë dhe kartë identiteti në përfaqësitë diplomatike
rezultoi e sukseshme me një masë realizimi 122% të aplikimeve për karta
identiteti jashtë vendit.

ARRITJE 2025



Prezantimi i platformës së Identitetit Digjital

Prezantimi shënon një hap të rëndësishëm drejt transformimit digjital të vendit.

ISO 27001:2022


Standardi Ndërkombëtar i Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim – ruajtja e certifikimit

ICAO PKD

Anëtarësimi i Shqipërisë në Drejtorinë së Çelësave Publike (PKD) të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, (ICAO)


Website i ri për IdentiTek

Përmirësime në dizajn, funksionalitet dhe përvojën e përdoruesit.



DOKUMENTE BIOMETRIKE NË SHQIPËRI 2025

Lloji i dokumentit	Viti 2025	%
ID me procedurë Normale	141,890	31%
ID me procedurë të shpejtë	36,230	8%
Pasaporta procedurë normale	193,765	42%
Pasaporta me procedurë të shpejtë	75,854	16%
Leje Qendrimi	15,226	3%
Total Dokumenteve Biometrike	462,965	100%



Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025 në Shqipëri janë lëshuar gjithsej **462,965** dokumente biometrike.

Pesha më e madhe i takon lëshimit të pasaportës me kupon normale, që përbën **42%** të totalit të dokumenteve të lëshuara.




DOKUMENTE BIOMETRIKE JASHTË VENDIT 2025

Letërnjoftim		
Ambasada/Konsullata	2025	%
Ambasada në Athinë	11,452	31%
Konsullata në Selanik	3,973	11%
Ambasada në Romë	2,412	6%
Konsullata në Milano	6,792	18%
Konsullata në Bari	887	2%
Akonsullata në SHBA	2,029	5%
Ambasada në Kanada	410	1%
Ambasada në Berlin	1,025	3%
Ambasada në Paris	1,666	4%
Ambasada në Stokholm	244	1%
Ambasada në Vienë	133	0%
Konsullata në Stamboll	139	0%
Ambasada në Bruksel	997	3%
Ambasada në Londër	4,104	11%
Konsullata në Munih	1,251	3%
Total	37,514	100%

Pasaportë		
Ambasada/Konsullata	2025	%
Ambasada në Athinë	17,631	27%
Konsullata në Selanik	7,416	12%
Ambasada në Romë	4,549	7%
Konsullata në Milano	13,427	21%
Konsullata në Bari	1,566	2%
Akonsullata në SHBA	2,210	3%
Ambasada në Kanada	397	1%
Ambasada në Berlin	2,418	4%
Ambasada në Paris	2,934	5%
Ambasada në Stokholm	559	1%
Ambasada në Vienë	246	0%
Konsullata në Stamboll	235	0%
Ambasada në Bruksel	2,110	3%
Ambasada në Londër	5,454	8%
Konsullata në Munih	3,127	5%
Total	64,279	100%


Gjatë vitit 2025 janë lëshuar gjithsej **101,793** dokumente biometrike jashtë vendit.

Pesha më e madhe i përket përfaqësisë së Athinës, me 31% të aplikimeve për kartë identiteti dhe 27% për pasaportë.




PRODHIMI SIPAS LLOJIT TË APLIKIMEVE 2025

Ndarja në % e aplikimeve për Letërnyfotime elektronike për vitin 2025






Ndarja në % e aplikimeve për Pasaporta për vitin 2025





RASTET E TRAJTUARA NË INVESTIGIM






RASTET E TRAJTUARA NË INVESTIGIM - 2025

Type INV	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Total
BIOMETRIC	3,153	3279	2,734	3856	3720	3586	5129	5974	2815	3258	2505	4,118	44,127
FINGERPRINT	87	178	203	289	190	128	109	138	140	102	90	173	1,827
Vetdeklarime Humbje	1117	1417	1262	1262	1937	1003	1156	1160	952	1099	1001	1371	14737
MN/RN	1712	1505	1375	1949	1768	1705	2413	3699	2139	1979	1492	2132	23868
Te Tjera	1008	1541	1338	1148	1812	1481	1655	1510	1792	1562	1535	1499	17881

Type INV	Total
BIOMETRIC	44,127
FINGERPRINT	1,827
Vetdeklarime Humbje	14737
Mirembajtje / Rinovim	23868
Te Tjera	17881





SHËRBIMI I KLIENTIT

**VLERËSONI
EKSPERIENCËN
TUAJ!**

identiTek

**Skanoni barkodin në
çdo zyrë të IdentiTek**
Ndhmoni në përmirësimin
e shërbimit tonë!

identiTek

**NJË EMAIL PËR
ÇDO PYETJE!**

kujdesi.klientit@identitek.al

Në Janar 2025 është vendosur në dispozicion një shërbim i dedikuar telefonik dhe një adresë email-i, ku qytetarët mund të drejtohen për çdo informacion apo ankesë.

Janë realizuar 18,534 thirrje, kemi marrë 2000 telefonata dhe 1,557 emailë, ku koha mesatare e përgjigjes së tyre është 10 minuta gjatë ditës së punës.

Nga vlerësimet për shërbimin e marrë në Zyrat e Aplikimit, Citizens Satisfaction Rate, 98% e tyre kanë qenë pozitive, duke na mundësuar standarde gjithnjë e më të larta për shtetasit.

Ndarja e shërbimeve (pajisja me pasaportë dhe kartë identiteti) në përfaqësitë diplomatike rezultoi e sukseshme me një masë realizimi 122% të aplikimeve për ID jashtë vendit.

Në vitin 2025 – 36913 ID

Në vitin 2024 – 30252 ID



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME PUSHTETIN VENDOR

Total Bashki	Kontaktuar	Ne Proces Firme	Firmosur	Refuzuar Perkoheisht
61	25	3	11	2
	41%	12%	44%	8%

IdentiTek ka nisur bashkëpunimin me njësitë vendore të bashkive për firmosjen e marrëveshjeve që sigurojnë përdorimin e ambienteve bashkiake për zyrat e saj.

Kjo do të mundësojë finalizimin e marrëveshjeve dhe krijimin e zyrave me standarde evropiane, duke ofruar shërbim dinjitoz për qytetarët.

KARTA E IDENTITETIT E SHPEJTË



KARTË IDENTITETI

PËR VETËM 3 DITË

e Hënë

e Martë

e Merkurë

Karta ID merret për tri ditë, koha për dokumentin reduktohet duke paguar 3 mijë lekë

Koha e pajisjes së qytetarëve me kartën e identitetit zbrit nga 14 ditë në 3 ditë. Kompania shtetërore "IdentiTek" njoftoi se kushdo që

Vizion Plus / Mar 28

Karta e Identitetit brenda tre ditësh! Kundrejt 3 mijë lekëve, aplikohet procedura e përshpejtuar

Karta e identitetit tashmë mund të merret brenda 3 ditësh nga dita e aplikimit.

Top Channel / Mar 28

Tani mund të pajiseni me kartë identiteti vetëm 3 ditë

Koha e pajisjes me ID Kartë zbrit nga 14 ditë në vetëm 3 ditë, njoftoi Ministria e Brendshme. Risia është lanuar nga IdentiTek, kompania shtetërore e prodhimit të dokumenteve biometrike, duke sjellë një shërbim të ri për qytetarët shqiptarë,...

noanews / Mar 24

Edhe kartat e identitetit brenda tre ditësh

Ashtu si pasaportat biometrike, edhe kartat e identitetit mund të merren brenda 3 ditësh. Kompania shtetërore IdentiTek ka lanuar risinë duke sjellë shërbimin e ri që mund të pajisë qytetarët me letërnjoftimin elektronik në mënyrë të shpejtë.


Tv Klan / Mar 28

Periudha	2025
Aplikime ID me procedurë standarde	138466
Aplikime ID me procedurë të shpejtë	36365
Pesha %	26.3%

Karta e Identitetit me Procedurë të Shpejtë (Fast ID) është lançuar në Mars 2025. Ky shërbim u mundëson shtetasve pajisjen me kartë identiteti brenda tre ditëve nga aplikimi.

Janë prodhuar 36,365 karta identiteti me procedurën Fast ID, që përfaqësojnë 26.3% të totalit të kartave të prodhuara.

KUPONI ELEKTRONIK “E-KUPON”



Pagesa online për kuponët për pasaportë apo kartë ID

Ministria e Brendshme dhe Kompania Shtetërore IdentiTek ShA e prodhimit të dokumenteve biometrike njoftojnë disa risi të rëndësishme, që sjellin përfitime për qytetarët, duke synuar modernizimin dhe përmirësimin e shërbimeve. Kështu...

TV Klan / Apr 8



Vijon digjitalizimi i shërbimeve për qytetarët: Kuponi për kartën e identitetit tashmë mund të sigurohet edhe online në 'IdentiTek'

Ministria e Brendshme dhe Kompania Shtetërore IdentiTek ShA e prodhimit të dokumenteve biometrike njoftojnë disa risi të rëndësishme, që sjellin përfitime për qytetarët, duke synuar modernizimin dhe përmirësimin e shërbimeve. Ervin...

shqiptarja.com



Rinovimi i mjeteve të identifikimit, tashmë kupon në mënyrë elektronike edhe nga IdentiTek

Rinovimi i mjeteve të identifikimit, tashmë kupon në mënyrë elektronike edhe nga IdentiTek

KTVSH / Apr 8



Eliminohen radhët fizike, IdentiTek lançon kuponin elektronik për dokumentet biometrike

Ministria e Brendshme dhe kompania shtetërore IdentiTek kanë prezantuar një sërë risish të rëndësishme në shërbimin e dokumenteve biometrike, duke modernizuar dhe përmirësuar ndjeshëm mënyrën se si qytetarët pajisen me pasaporta dhe kart...

A2CNN / Apr 8

Periudha	2025	%
Ambasada	3004	51%
Shqipëri	2935	49%
Total	5939	100%

Kuponi elektronik (e-kuponi) i lançuar në prill 2025, u mundëson qytetarëve të blejnë dhe të paguajnë online tarifat për kartën e identitetit dhe pasaportën, si brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Deri më tani janë blerë online **5,939** kupona elektronikë, nga të cilët **51%** janë blerë në përfaqësitë diplomatike.

GJURMO DOKUMENTIN E IDENTIFIKIMIT



Qytetarët kanë mundësinë të kontrollojnë online, në çdo moment, ecurinë e dokumentit të tyre përmes <https://gjurmo.identitek.al/>, .

Që nga pranimi i kërkesës, përmes procesit të prodhimit e deri në momentin e tërheqjes së dokumentit, çdo hap është i qartë dhe transparent.

Kjo i lehtëson qytetarët, duke kursyer kohë, shmangur pritjet e panevojshme dhe duke ofruar informim të menjëhershëm dhe të sigurt.

Shërbimi është aksesuar **31,138** herë, me një mesatare prej **84%** të aplikimeve të realizuara në këtë periudhë.



NËNSHKRIMI ELEKTRONIK E-SIGNATURE 2025

Numri i ditëve për të firmosur	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Mesatar e
0-1	52.1%	70.0%	61.7%	83.1%	88.9%	90.5%	85.8%	89.7%	90.0%	96.0%	95.5%	92.5%	83.0%
2	13.6%	7.8%	13.4%	5.1%	3.7%	2.3%	3.4%	2.9%	2.2%	1.5%	1.8%	1.3%	4.9%
3+	30.1%	18.3%	15.2%	6.8%	3.4%	2.9%	6.9%	2.6%	4.1%	2.5%	2.2%	6.1%	8.4%
Pa Firmosur	4.2%	3.9%	9.7%	5.0%	4.0%	4.3%	3.9%	4.8%	3.7%	0.0%	0.5%	0.1%	3.7%

Projekti e-Signature në përfaqësitë diplomatike ka përgjysmuar kohën e dërgimit të dokumenteve biometrikë, duke përmirësuar përvojën e qytetarëve të diasporës përmes shërbimeve më të shpejta dhe plotësisht të digjitalizuara.

Shtetasit që ndodhen jashtë vendit marrin dokumentin biometrik brenda vetëm **2 javëve**, në të njëjtën kohëzgjatje si në Shqipëri.

Tabela më sipër paraqet kohën e firmosjes elektronike për aplikimet e kryera në përfaqësitë diplomatike, e cila është e lidhur ngushtë me afatin e dërgesës së dokumenteve biometrikë.

Në total, 96% e tyre firmosen brenda ditës.

KPI 2025

IDENTITEK

HARTA KONCEPTUALE E TREGUESVE KYC TË PERFORMANCËS (KPI) IDENTITEK 2025		
QËLLIMI KRYESOR: OFRIMI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE, TË BESUESHME DHE EFIKASE PËR PRODHIMIN E DOKUMENTEVE BIOMETRIKE, DUKE PËRFSHIRË TË GJITHË HAPAT NGA APLIKIMI TEK SHPËRNDARJA E TYRE, PËR SHTETASIT SHQIPTARË BREND A E JASHTË VENDIT DHE SHTETASIT E HUAJ QË JETOJNË NË SHQIPËRI		
Objektivi	Indikatori	Statusi Dhjetor 2025
I. Mbajtja e një standardi të lartë për ofrim shërbimi në kohë e në mënyrë profesionale	1. Prodhimi dhe shpërndarja në kohë e Letërnjoftimit Elektronik brenda dhe jashtë vendit	I arritur në masën 100%
Përfshin respektimin e afateve të prodhimit dhe shpërndarjes së dokumenteve biometrike si edhe ofrimin e shërbimeve me nivel të lartë ndaj qytetarëve gjatë çdo procesi aplikimi për pajisjen me dokumente biometrike.	2. Prodhimi dhe shpërndarja në kohë e pasaportës biometrike brenda dhe jashtë vendit	I arritur në masën 100%
	3. Prodhimi dhe shpërndarja në kohë e dokumentit biometrik për shtetasit e huaj që jetojnë në Shqipëri	I arritur në masën 100%
	4.Përmirësimi i bazës ligjore për të përmirësuar e standartizuar praktika	I arritur në masën 100%
	5. Mbajtja e pasqyrave financiare të shoqërisë sipas standardeve ndërkombëtare të Raportimit Financiar	Raportimi i këtij indikatori do të kryhet gjatë tremujorit të parë të vitit 2026 – kur të kryhet auditimi financiar nga auditi i jashtëm i shoqërisë.
II. Inovacioni Teknologjik	6. Marrja dhe ruajtja e certifikimit ISO (Standardi Ndërkombëtar i Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim)	I arritur në masën 100%
Siguron që kompania të jetë në gjendje të përdorë teknologji në mënyrë efikase për të garantuar sigurinë dhe integritetin e produkteve dhe shërbimeve të saj të saj, duke qëndruar në krye të zhvillimeve teknologjike në fushën e prodhimit të dokumenteve të identifikimit biometrik.		Certifikimi u mor në gusht 2024 Kontrolli vjetor dhe ruajtja e certifikimit, u krye në korrik 2025.
	7. Numri i projekt propozimeve të hartuara me synim zhvillimin e aplikacioneve apo produkteve të reja	I arritur në masën 100% 1.Projektit “ID dixhitale” Projekti ID dixhitale u përfshi në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare në Gusht 2024. Gjatë viti 2025 është punuar për gjetjen e zgjidhjeve teknike për zbatimin e Projektit; 2. Projekti “Karta e Identitetit e Shpejtë”; 3. Projekti “Gjurmo Dokumentin e Identifikimit”; 4. Projekti “Nënshkrimi Elektronik E-Signature”; 5. Projekti “Shërbimi i Klientit”
III. Anëtarësimi në ICAO PKD		I arritur në masën 100%
Garanton njohjen e pasaportës biometrike shqiptare nga Drejtoria e Celësave Publikë (PKD) të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO)	8. Regjistrimi dhe anëtarësimi i IdentiTek në ICAO PKD	Regjistrimi u arrit në tetor 2024; Anëtarësimi u arrit në Mars 2025. IdentiTek po zbaton cdo kërkesë të ICAO-s për përmbushjen e standardeve lidhur me dokumentet biometrike

PLATFORMA E IDENTITETIT DIGJITAL




IdentiTek, prezanton platformën e Identitetit Digjital

Identiteti digjital, u prezantua me datë 20 Tetor, duke shënuar kështu një hap të rëndësishëm drejt transformimit digjital të vendit.

Me zhvillimet e reja, identiteti si një pjesë thelbësore, që lidh qytetarin me shtetin do të marrë një formë të re nga fizike në digjitale, me të cilin qytetarët, institucionet publike e bizneset, mund të nënshkruajnë, paguajnë dhe të kryejnë veprime të sigurta nga telefoni nga çdo vend, në çdo moment.



ANËTARESIMI NË ICAO PKD



Shqipëria anëtarësohet në Drejtorinë e Çelësave Publikë (PKD) të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO), si vendi i 99-të, që i bashkohet kësaj Organizate.

ICAO PKD është një platformë globale për shkëmbimin e informacionit mbi dokumentet e udhëtimit, duke ndihmuar vendet anëtare në verifikimin e pasaportave biometrike.

Si agjenci e Kombeve të Bashkuara, ICAO bashkëpunon me 193 shtete, për të garantuar rrjet të sigurt e të shpejtë për mobilitetin ajror global.

Anëtarësimi i Shqipërisë në ICAO PKD e pozicionon vendin në nivel më të lartë besueshmërie dhe bashkëpunimi në arenën ndërkombëtare.

Kjo do të thotë se autenticiteti i pasaportës shqiptare njihet nga të gjitha shtetet pjesëtare të ICAO PKD, çka rrit ndjeshëm sigurinë kufitare, ndihmon luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit në nivel global.

CERTIFIKIMI ISO 27001



IdentiTek ka arritur me sukses certifikimin sipas standardit nërkombëtar ISO 27001:2022 nga TÜV AUSTRIA, organizata lider e certifikimit dhe inspektimit në Shqipëri. Ky certifikim pasqyron përkushtimin e kompanisë për përmbushjen e kërkesave të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit, duke garantuar nivelin më të lartë të sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave sensitive personale.

ISO 27001:2022 është standardi më i njohur global për menaxhimin e sigurisë së informacionit. Ky standard përshkruan praktikën më të mirë për mbrojtjen e informacionit të ndjeshëm, duke siguruar standarde të larta të menaxhimit.

IdentiTeK e kaloi këtë certifikim në gusht 2025.

WEBSITE I RI I IDENTITEK



The screenshot shows the new IdentiTek website. At the top is a blue navigation bar with the IdentiTek logo, menu items (Kreu, Procedura, E-Kupon, Gjurmë, Rreth Nesh, Komunikime, Programi i Transparencës, EN), and an 'Apliko Tani' button. The main banner features a man at a laptop with the headline 'IDENTITETI JUAJ, INTEGRITETI YNË!' and a sub-headline explaining the service. Below this are three service tiles: 'e-Kupon N'ÇAST NGA IDENTITEK', 'Gjurmë Dokumentin N'ÇAST', and 'Kartë Identiteti me procedurë të shpejtë'. The lower section has a blue background with the headline 'ZYRAT TONA BRENDË DHE JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË!' and a map of Albania with service locations marked by blue circles and numbers. A sidebar on the left lists various administrative offices.

IDENTITETI JUAJ, INTEGRITETI YNË!

IdentiTek është një shoqëri aksionare me standarde të larta sigurie, e vetmja në Shqipëri që ofron regjistrimin, prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike të shtetasve shqiptarë dhe/ose shtetasve të huaj me banim të përhershëm apo të përkohshëm në Republikën e Shqipërisë.

[Na kontaktoni](#)

e-Kupon N'ÇAST NGA IDENTITEK

Gjurmë Dokumentin N'ÇAST

Kartë Identiteti me procedurë të shpejtë

ZYRAT TONA BRENDË DHE JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË!

Rrjeti i zyrave të aplikimit dhe shpërndarjes ka një shtrirje gjeografike të tillë që t'i mundësojë çdo qytetari një shërbim lehtësisht të aksesueshëm.

Map **Satellite**

Kërko Qytetin

- IdentiTek Bashkia Berat
- IdentiTek Bashkia Ura Vajguore
- IdentiTek Bashkia Kuçovë
- IdentiTek Bashkia Poliçan
- IdentiTek Bashkia Peshkopi
- IdentiTek Njësia Adm. Maqellarë
- IdentiTek Bashkia Burrel
- IdentiTek Bashkia Klos

Map data ©2023 Google, Imagery ©2023 Google, Labels ©2023 Google

The graphic features a woman in a yellow shirt holding a passport and a smartphone. To her right is a list of services under the heading 'PROCEDURAT E APLIKIMEVE'. The services are: 'Aplikim për Pasaportë', 'Aplikim për Kartë Identiteti', and 'Aplikim për Leje Qëndrimi'. Each service has a corresponding icon and a right-pointing arrow.

PROCEDURAT E APLIKIMEVE

IdentiTek sh.a. ofron aplikimin, prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike si: pasaporta biometrike, letërmjotim elektronik, leje qëndrimi për shtetasit e huaj etj.

- Aplikim për Pasaportë**
- Aplikim për Kartë Identiteti**
- Aplikim për Leje Qëndrimi**


IdentiTek ka lancuar faqen e re të internetit, e cila sjell përmirësime në dizajn, funksionalitet dhe përvojën e përdoruesit, duke ofruar:

- Dizajn të optimizuar për një eksperiencë sa më miqësore për përdoruesin.
- Format të thjeshtuar për procedurat e aplikimit.
- Hartë të përditësuar dhe ndervepruese të zyrave të IdentiTek.
- Integrim të shërbimeve si *e-kuponi* dhe *gjurmë.dokumentin*.

EVENTET TË TJERA GJATË 2025



- Pjesëmarrja në panairin “Future2Tech”, e cila rezultoi shumë e suksesshme në aspektin e bashkëpunimeve që sollën njohjen e IdentiTek edhe më gjerë si edhe në rritjen e bazës së ndjekësve në rrjetet sociale.
- Si pjesë e përgjegjësisë sociale, dy iniciativa bamirësie, në bashkëpunim me Shtëpinë e Fëmijës “Zyber Hallulli” dhe organizatën “Caritas Albania” u realizuan me fondet e stafit të IdentiTek.



FALEMINDERIT!

